



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

05.Nr 2042 /2024

DATE:	14.11.2024
REFERENCË:	02/8822/2024
PËR:	Kandidatët/Publikun
NGA:	Hisni Luri -Drejtor i Drejtorisë për Arsim
TEMA:	Njoftim për kandidatët në procedurën e rekrutimit "Mësimdhënës/e për lëndën Matematikë"

Të nderuar,

Drejtoria për Arsim ju njofton që edhe përkundër përpjekjeve për të katërtën herë për përzgjedhjen e "Mësimdhënësit për lëndën matematikë " zëvendësim pushim i lehonisë në shfmu "Veli Ballazhi" në fshatin Gorancë, është e pa mundur vazhdimi i procedurës së rekrutimit sipas rregullave të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarë Publik konkretisht rekrutimi i shërbyesve publik, andaj në mënyrë që të përmbushim obligimin ligjor që na obligon Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 3, paragrafi 3, ku përcaktohet: "Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, **komunave**, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejta të barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social." ne si drejtori duke u mbështetur në nenin 31, paragrafi 2, i të njëjtit ligj i cili përcakton se "Një person i cili nuk i përmbush kushtet e nevojshme për të qenë mësimdhënës mund të punësohet në një institucion arsimor dhe aftësues si asistent apo instruktor për të ndihmuar punën e një mësimdhënësi të kualifikuar dhe të licencuar, nëse drejtori i institucionit është i bindur se ky person posedon aftësitë, ekspertizën dhe përvojën e nevojshme për një punë të tillë." Po ashtu, neni 35, paragrafi 5, thekson: "Kur bëhet përzgjedhja midis një apo më shumë kandidatëve për një post menaxhues ose për mësimdhënës, merren për bazë kushtet, si janë: arsimimi i secilit kandidat, përvoja, kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësojë ky emërim. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet për kualifikim, mund të bëhet një emërim i përkohshëm, që përfundon në ditën e fundit të vitit shkollor gjatë të cilit është bërë emërimi." Do të bëjmë emërimin e kandidatit më të favorshëm në këtë pozitë dhe kohëzgjatja e mardhënies së punës për të do të jetë vetëm disa muaj pasi që përfundon pushimi i lehonisë për nëpunësen që mban këtë pozitë.

Me respekt ,